



Pranimi / Dorezimi Pranimi / Prudato Received / Delivered	27.04.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shfitorja Pulog Appendix	Sasia Kolicitma Quantity
SKPM/SHCK	2459/2022		1/4



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.255/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.255/2022 të datës 21.03.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi në Komunën e Prishtinës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 27.04.2022, mori këtë:

### V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.255/2022 e datës 21.03.2022 e parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ministria e Punëve të Brendshme duke u bazuar në dispozitat e nenit 40 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe nenit 6 paragrafit 1.4 të Rregullores (QRK) Nr.15/2020 Për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e nëpunësve të Nivelit të Lartë Drejtues, fillimisht me datën 23.09.2021 ka njoftuar lidhur me konkursin, ndërsa me datën 23.10.2021 ka shpallur konkursin me numër të referencës RN00007647 për pozitën e punës "Drejtor i përgjithshëm" në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës.

Në bazë të listës së aplikacioneve në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, cili është përfshirë në listën e ngushtë, testimin me shkrim dhe me gojë. Me datën 02.12.2021, Komisioni Shtetëror për Pranimin lidhur me Pozitat e Nivelit të Lartë Drejtues, ka nxjerrë vendimin me numër Nr.08/2021



sipas te cilit janë propozuar dy kandidatë për emërim, ku njëri ndër ta ka qenë edhe ankuesi me numrin me te madh të pikëve gjithsejtë 76.31 pikë.

Me datën 17.12.2021, Ministria e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ka reaguar me shkresë zyrtare ndaj përzgjedhjes së dy kandidateve për këtë pozitë nga komisioni vlerësues, me arsyetimin se asnjëri nga dy kandidatët e propozuar nuk janë të duhurit për udhëheqjen e kësaj agjencie dhe se asnjëri nga kandidatët nuk kanë performuar mirë.

Ankuesi i pakënaqur me mos përgjigjen nga ana e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë lidhur me emërimin e tij për pozitën e Drejtorit të përgjithshëm në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës, me datën 21.03.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1471/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me vonesën e përgjigjes nga ana e DMZP-së, i njëjti kërkon nga ana e Këshillit që të ndërmarr veprimet ligjore për mos veprimin e organit kompetent lidhur me këtë çështje.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 23.09.2022, ka proceduar kërkesën me numër të protokollit 1541/2022 për përgjigje në ankesë tek Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publike të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa me datën 04.04.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publike i Ministrisë së Punëve të Brendshme së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr.Prot:1471/2022 të datës 21.03.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 03.12.2021 nga DMZP-ja për kandidatët fitues në bazë të vlerësimit nga komisioni shtetëror i pranimit; Njoftimin e datës 17.11.2021 nga DMZP-ja për listën e ngushtë; Njoftimin e datës 25.11.2021 përmes e-mailit zyrtar lidhur me ftesën në testimin me shkrim të ankuesit; E-mailin zyrtar të datës 03.02.2022; E-mailin zyrtar të datës 17.11.2021; E-mailin zyrtar te datës 29.12.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 23.03.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 04.04.2022 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publike i Ministrisë së Punëve të Brendshme; Akt emërimin e ankuesit te datës 06.01.2021 me numër AE.Nr.24/2021; Konkursin e datës 23.10.2021 për pozitën Drejtor i përgjithshëm në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës; Vendimin me numër Nr.08/31 të datës 25.08.2021 lidhur me emërimin e komisionit shtetëror të pranimit për pozitat e kategorisë së larte drejtuese; Listën e aplikantëve me numër të referencës RN00007647; Njoftimin e datës 17.11.2021 lidhur me listën e ngushtë të kandidatëve; E-mailin zyrtar te datës 25.11.2021 lidhur me ftesën për testimin me shkrim të kandidatit konkurrues M.P; Njoftimin e datës 17.11.2021 përmes e-mailit zyrtar lidhur me njoftimin për listën e shkurtër për kandidatin M. P; Njoftimin e datës 25.11.2021 përmes e-mailit zyrtar lidhur me ftesën për testimin me shkrim për kandidatin I.E; Njoftimin e datës 17.11.2021 përmes e-mailit zyrtar për listën e shkurtër për kandidatin I.E; Vendimin me numër Nr.08/2021 të datës 02.12.2021 për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve; Renditjen përfundimtare te datës 02.12.2021; Shkresën zyrtare të datës 17.12.2021 nga Ministria e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; Aplikacionin për punësim te ankuesit te datës 04.11.2021 me shkresat e bashkangjitura në lëndë mbi përvojën e shkollimit dhe atë profesionale;



Aplikacioni për punësim i datës 25.10.2021 për kandidatin S.A se bashku me shkresat e bashkangjitura në lëndë mbi përvojën e shkollimit dhe atë profesionale; Aplikacioni për punësim i datës 04.11.2021 për kandidatin M.P së bashku me shkresat e bashkangjitura në lëndë mbi përvojën e shkollimit dhe atë profesionale; Aplikacioni për punësim i datës 04.11.2021 për kandidatin Xh.D së bashku me shkresat e bashkangjitura në lëndë mbi përvojën e shkollimit dhe atë profesionale; Aplikacioni për punësim i datës 02.11.2021 për kandidatin I.E së bashku me shkresat e bashkangjitura në lëndë mbi përvojën e shkollimit dhe atë profesionale.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa lejuar, **SEPSE:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Shtetëror i Pranimit për pozitat e nivelit të lartë drejtues me datën 02.12.2021, ka nxjerrë vendimin me numër Nr.08/2021 sipas të cilit për pozitën "Drejtor i përgjithshëm" në Agjencinë e Meteorologjisë së Kosovës janë propozuar dy kandidatë për emërim, me ç' rast ankuesi është radhitur i pari me pikë gjithsej 76.31 pikë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës konstaton se që nga koha kur është nxjerrë Vendimi me numër Nr.08/2021 i datës 02.12.2021 nga Komisioni Shtetëror i Pranimit për pozitat e nivelit të lartë lidhur me propozimin e kandidatëve për emërim për pozitën "Drejtor i përgjithshëm" në Agjencinë e Meteorologjisë së Kosovës, e deri tek data 21.03.2022 kur ankuesi e ka parashtruar ankesën me numër protokolli 1471/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kanë kaluar të gjitha afatet ligjore të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "**Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ**", ndërsa sipas nenit 51 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "**Një akt administrativ fillon të prodhojë pasojat juridike në raport me palën të cilës i drejtohet apo e cila cenohet nga ai, me njoftimin e përmbajtjes të tij**", si rrjedhojë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar më datë 21/03/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është në kundërshtim edhe me dispozitën e nenit 125 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: "**Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative të paraparë sipas nenit 127 paragrafi 4 të këtij ligji, andaj mbi këto baza ligjore të specifikuar më lartë, ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e papranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: "Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji", në këtë rast ankesa e ankuesit është e parashtruar jashtë afatit ligjor sipas dispozitave të lartcekura.**




Andaj në kuptim të kësaj dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ankesa e ankuesit [redacted] është e palejuar.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.255/2022, datë 27/04/2022

Ardita Perçaku-Shyti

  
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

  
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit [redacted]
- Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë e Meteorologjisë së Kosovës;
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Udhëheqëses së Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin e Menaxhimit të Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

